



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU KUKËS
BASHKIA HAS
Njësia Administrative Golaj

PROJEKT PËRMIRËSIM PYJESH

Fshati: Letaj
Zona kadastrale: 1832
Emri popullor i vendit: Rezervuari Letaj
Ekonomia Pyjore: Helshan
Ngastra/Nënngastra: 13b

PROJEKTUESI

KONTROLLOHET

(KONTROLI NGA STRUKTURA E PYJEVE NË BASHKI)

MIRATOHET

(MIRATIMI NGA AGJENCIA KOMBETARE E PYJEVE)

JANAR 2025



KAPITULLI I

1.PROJEKT PËRMIRËSIMI PYJESH

Emri i objektit:	Rezervuari Letaj
Njësia e Vetëqeverisjes Vendore:	Golaj
Fshati:	Letaj
Ekonomia Pyjore:	Helshan
Ngastra, n/ngastra:	13b
Sipërfaqja totale:	13.5 ha
Sipërfaqja që do përshkohet me punime:	1.35 ha
Lloji i ndërhyrjes:	Rrallime para tregtare në llojin Bungë

KAPITULLI II

2.QËLLIMI I PËRMIRËSIMIT DHE KARAKTERISTIKAT STACIONALE

2.1.Qëllimi i përmirësimit

Ndërhyrja ka për qëllim përmirësimin e gjendjes ekzistuese për përsheptimin e procesit natyror të rritjes, nëpërmjet favorizimit të drurëve me zhvillim dhe rritje të mirë, duke krijuar kushte optimale të hapësirës, ushqimit dhe dritës, për rritjen e prodhimtarisë së grumbullit pyjor të Bungës.

2.2.Pozicioni i objektit

Objekti ndodhet pranë rrugës auto që lidh fshatrat Letaj dhe Peraj, të Nj.Adm. Golaj, Bashkia Has. Po ashtu ndodhet rreth 700 m pranë rrugës kryesore që lidh pikën kufitare të Qafë-Prushit me Krumën. Ndodhet në pjesën jugperëndimore të rezervuarit të ujit Letaj. Distanca nga objekti ku do të bëhet përmirësimi i pyjeve me qendrën e Nj. Ad. Golaj është rreth 7 km., nga qendra e Bashkisë Krumë, 16 km dhe fshati Letaj, 1 km.

2.3. Vendosja Gjeografike dhe administrative

Objekti në të cilin do të ndërhyhet me përmirësim pyjesh ndodhet në vendin e quajtur Rezervuari Letaj dhe bën pjesë në ekonominë pyjore Helshan në zonën kadastrale 1832, N/parcela nr. 13b, në Nj. Admin. Golaj, Bashkia Has, me koordinatat gjeografike 42°17'37.15"N dhe 20°22'33.20"E.



2.4. Përdorimi i deritanishëm

N/ngastra 13b është trajtuar si grumbull pyjor me funksion prodhues, po ashtu edhe pas hartimit të planit të mbarështrimit kryer nga ABKONS për EP Helshan për periudhën 2020-2030.

2.5. Klima¹

Objekti ndodhet në zonën fitoklimatike të dushqeve (Quercetum), bën pjesë në klimën mesdhetare paramalore veriore, ku dallohet për verën e freskët dhe dimër të lagësht e të ftohtë më ngrica e dëborë.




Figura 1. Grafiku i temperaturave mesatare mujore dhe vjetore

Temperatura mesatare vjetore arrinë 11.4 °C. Në shpërndarjen mujore të temperaturave vërehet se Janari është muaji më i ftohtë me vlera mesatare zakonisht -4°C deri 4°C. Temperaturat më të larta takohen gjatë muajit Korrik e Gusht, ku Korriku është muaji më i nxehtë me vlera mesatare të temperaturave 14 °C deri 28°C. Ditët me temperatura nën 0° C variojnë nga 20-30 ditë në vit.




Figura 2. Grafiku i reshjeve mesatare mujore dhe vjetore

¹<https://weatherspark.com/y/85651/Average-Weather-in-Krum%C3%AB-Albania-Year-Round#Figures-Rainfall>



Sasia vjetore e reshjeve varion nga 900 -1000 mm/vit. Sasi më e madhe e reshjeve është regjistruar gjatë periudhës Tetor - Mars në sasi mbi 600 mm. Sasi më e vogël e reshjeve është regjistruar gjatë muajit Korrik në sasi 28 mm. Në këtë zonë bien edhe reshje dëbore që zakonisht zgjatin gjatë periudhës Nëntor – Mars, ku ditët me dëborë zgjatin rreth 30 ditë gjatë kësaj periudhe dhe reshjet e dëborës variojnë mesatarisht nga 25 mm deri 124 mm.

2.6. Toka

Toka është e kafenjtë, nëntipi i kuqërremtë ose Calcaro-Chromic Cambisols sipas klasifikimit FAO (1974). Janë toka të maleve të ulëta të zonës së pyjeve të dushkut, të kondicionuara nga klima mesdhetare paramalore e malore. Formohen mbi produktet e alterimit (cipat e kuqërremta) të gëlqerorëve (në zonat me reshje të shumta dhe ndryshueshmëri klimatike midis dimrit dhe verës) dhe silikateve, kryesisht të konglomerateve dhe shtufëve ranorë. Kanë përbërje mekanike subargjilore të rëndë deri argjilore, strukturë kokrrizore granulare të paqëndrueshme dhe reaksion acid (pH nga 4 – 5.5). Janë toka të varfëra në fosfor të asimilueshëm për shkak të përmbajtjes së konsiderueshme të oksideve të hekurit dhe aluminit, fosfori kalon në formën e kripërave të patretshme. Në objektin e përmirësimit të pyjeve përmbajtja e lëgushës mesatarisht shkon nga 3-5 cm.

2.7. Orografia

Forma e rielievit është fundshpati, me shkëmb amnor sedimentar.

2.8. Kundrejtimi

N/ngastra 13b ka kundrejtimit veriperëndimor.

2.9. Pjerrësia

Objekti ku do të ndërhyhet me punime përmirësimi të pyjeve ka pjerrësi maksimale 15%.

2.10. Lartësia mbi nivelin e detit

Lartësia mesatare mbi nivelin e detit të objektit është 625 m, ndërsa lartësia minimale është 616 m dhe ajo maksimale 634 m mbi nivelin e detit.

2.11. Veshja bimore

Bazuar në të dhënat e planit të menaxhimit të pyjeve të hartuar nga kompania ABKONS për periudhën 2020 deri në vitin 2030, grumbulli pyjor në këtë nënparcelë përfaqëson një përzierje të *Quercus petraea*, *Acer pseudoplatanus* dhe *Acer tartaricum*, me funksion prodhues dhe regjim trajtimi si cungishte. Si nënpyll gjenden shkoza, ferra, dëllinja e kuqe, etj. Bimësia



barishtore është e rrallë me një shkallë mbulimi më pak se 5% dhe dominohet nga llojet graminore.

2.12.Rezultatet e pritshme (Konkluzione)

Nga kjo ndërhyrje pritet të arrihen disa rezultate, të cilët shkurtimisht po i renditim si më poshtë:

- Rritja e cilësisë së drurit. Drurët e mbetur kanë rritje mesatare vjetore më të shpejtë dhe prodhojnë lëndë drusore me cilësi më të lartë, duke rritur vlerën tregtare të tyre;
- Përmirësimi i shëndetit të pyllit. Reduktimi i konkurrencës për burime si drita dhe lëndët ushqyese tokësore kontribuon në një ekosistem më të shëndetshëm;
- Menaxhimi i sëmundjeve. Rrallimi mund të ndihmojë në parandalimin e përhapjes së sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Krijimi i hapësirave për bimësi të tjera. Hapësirat e krijuara do të lejojnë zhvillimin e bimëve të tjera dhe rritjen e biodiversitetit;
- Mundësi për aktivitete njerëzore. Rritja e hapësirave do të krijojë mundësi për aktivitete si ecja dhe turizmi.
- Punësimi. Projekti do të krijojë vende pune për banorët lokalë, duke kontribuar në ekonominë familjare të zonës.



KAPITULLI I III

3.TË DHËNAT SPECIFIKE PËR PARCELAT

3.1 Përshkrimi i grumbullit pyjor

Nr. Parc.	Sip. (ha.)	Llojet Përbërëse	Mosha (vjet)	Lartësia (m.)	Diametri (cm.)	Kurorëndësia	Volumi (m ³ /ha)	Nr. Drurëve/ha	Sip.bazimetrike m ² /ha.	Gjendja sanitare vegetative	Masat e propozuara	viti i ndërhyrjes
13b	13.5	Bungë	25	6.4	6.7	1	75.8	4739	16.7	E mirë	Rrallime para tregtare	2021

3.2 Përshkrimi i grumbullit pyjor pas ndërhyrjes

Nr. Parc	Sip. (ha.)	Llojet përbërëse	Mosha (vjet)	Lartësia (m.)	Diametri (cm.)	Kurorë dendësia	Volumi (m ³ /h)	Nr. drurve /ha	Sip. bazimetr ike m ² /ha.	Gjendja sanitare vegetative
13b	13.5	Bungë	25	6.4	6.7	0.8	56.8	3554	12.5	Sh. mirë

3.3 Volumi i materialit drusor që do hiqet si rrjedhojë e ndërhyrjeve

Nr. Parc	Sip. (ha.)	Llojet Përbërëse	Lartësia (m.)	Diametri (cm.)	Nr.Dru/ha do të hiqen	Volumi (m ³ /dru)	Volumi (m ³ /ha)	Volumi ngas.(m ³)	Asortimenti
13b	1.35	Bungë	6.4	6.7	1185	0.016	18.96	25.6	Hunj, fashina, dru zjarri



3.4. ZBATIMI I PUNIMEVE

3.4.1. Historiku i punimeve të kryera

Në objekt nuk janë kryer punime të mëparshme, me përjashtim të prerjeve spontane nga popullsia lokale për sigurimin e druve të zjarrit ose për bazë ushqimore (gjeth). Si rezultat i largimit të popullsisë dhe uljes së numrit të bagëtive, presioni mbi këtë sipërfaqe pyjore ka rënë, duke ndikuar në përmirësimin e gjendjes dhe krijimin e një masivi pyjor që ka nevojë për përmirësime pyjore.

3.4.2. Mënyra e përmirësimit

Modeli teknik që do të zbatohet gjatë ndërhyrjes janë rrallimet para tregtare ose ndryshe rrallime të tipit I-rë, të cilat përkojnë me kufirin e sipërm të moshës së grumbullit pyjor në n/gastrën 13b (30 vjet) për ndërhyrje të këtij lloji. Në gjendjen aktuale të grumbullit është e nevojshme ndërhyrja me heqjen e 25% të numrit të drurëve. Do të hiqen ata të nënshtruarit, të tharët, të dëmtuarit dhe pa të ardhme të llojit të bungës, si dhe duke ndërhyrë me prerje të llojeve të tjerë me më pak vlera të grumbullit në mënyrë që të krijohet mundësia e optimale e zhvillimit sa më të mirë dhe të shpejtë të drurve të llojit bungë.

3.4.3. Intensiteti

Intensiteti i ndërhyrjes do të jetë 25% të numrit të drurëve. Intensiteti është llogaritur me formulën e mëposhtme:

$$I_v = V_n/V_f \times 100 \quad \text{====} > \quad I_v = 25.6/102.3 \times 100 = 25\%$$

Ku:

I_v : Intensiteti ndërhyrjes

V_n : Volumi i drurëve që do të hiqen

V_f : Volumi i drurëve para ndërhyrjes

3.4.4. Periodiciteti i prerjeve

Në n/ngastrën 13b nuk janë kryer ndërhyrje prej një kohe të gjatë, janë të vonuara edhe duhet të kryhen në një periodicitet 3-5 vjet, i cili është në përputhje edhe parashikimet e punimeve në planin e mbarështimit të EP Helshan për periudhën 2020-2030. Të paktën duhet të kryhen edhe 3 ndërhyrje të tjera me rrallime të tipit të I-rë me intensitet 25% të numrit ekzistues të drurëve brenda një periudhe 5-7 vjeçare, duke i krijuar mundësi më optimale grumbullit pyjor për rritje në lartësi dhe diametër. Pas një periudhe 10-15 vjeçare kur grumbulli pyjor të hyjë në



fazën e maturimit, ndërhyrjet duhet të bëhen me rrallime të tipit të II-të me periodicitet 5-10 vjet.

3.4.5. Teknika e zbatimit të punimeve

Proceset e punës gjatë ndërhyrjes me rrallime janë: (i) prerja e 25% të numrit të drurëve në objekt; (ii) grumbullimi i materialit drusor në togje; (iii) vlerësimi i materialit drusor dhe përdorimi për ndërtimin e gardheve çift aty pranë.

Do të hiqen drurët më të dobët, të nënshtuar, me majë të thyer, të tharë, të bigëzuar, të infektuar nga sëmundje apo dëmtues, etj. Drurët të cilëve do u jepet përparësi duhet të jenë të shëndetshëm, me lëvore të pastër dhe vrull të madh rritje; të kenë qëndrim të drejtë, të jenë pa të meta (çarje, degë thithake, etj.); të kenë kurorë uniforme dhe simetrike dhe me majën e mprehtë, si një tregues për rritje aktive vjetore.

Për prerjet do të përdoren mjete të mprehta, si sopata, kosorja dhe motosharra me qëllim që prerja të bëhet sa më e lehtë dhe sa më afër tokës. Paraprakisht, para fillimit të punimeve duhet bërë instruktimi teknik i punëtorëve, duke demonstruar sipërfaqe model në prani të personelit teknik pyjor.

3.4.6. Sasia e materialit drusor që prodhohet

Nga ndërhyrjet me rrallime para tregtare në n/ngastrën 13b llogaritet të rezultojnë 18.96 m³/ha dhe 25.6 m³/objekt me sipërfaqe 1.35 ha.

3.4.7. Destinacioni i materialit të prodhuar

Materiali që rezulton nga ndërhyrja do të përdoret për ndërtimin e 120 ml gardheve çift në afërsi të objektit të rrallimit.

3.4.8. Masat mbrojtëse

Me këtë ndërhyrje nuk është e nevojshme marrja e masave mbrojtëse ndaj kullotjes, pasi drurët e mbetur janë mbi 2 metra lartësi që të mund të shkaktohen probleme të rritjes, gjithashtu numri i blegtorisë në fshat nuk është i madh.

3.4.9. Rreziqet

Rreziqet potenciale që mund të shkaktohen nga ndërhyrja janë tepër minimale, siç është erozioni sipërfaqësor, humbja e lëndës organike dhe elementëve ushqyes nëçeltirat e krijuara, zvogëlim i mikro florës dhe faunës, rritje e temperaturës së tokës dhe gjallërimi i bimësisë barishtore, por kjo është e përkohëshme dhe nuk nevojiten masa shtesë. Një rrezik potencial më i qënësishëm është ai i zjarreve, por për këtë material drusor i grumbulluar në togje do të



hiqet nga pylli dhe do të përdoret për ndërtimin e 120 ml gardhe çift, në zonën e cila ndodhet në kufirin verior të objektit.

KAPITULLI I IV

4. KRYERJA E PUNIMEVE

4.1.Grafiku i punimeve

PP-1	Ndërhyrja me rrallime paratregtare	Janar 2025 (6 puntore x 250 m ² /dite x 9 dite pune)
Objektivi 1	Përmirësimi i gjendjes ekzistuese për përshpejtimin e procesit natyror të rritjes, nëpërmjet favorizimit të drurëve me zhvillim dhe rritje të mirë	3-13 Shkurt 2025
PP lider	Kompania zbatuese e punimeve	3-13 Shkurt 2025
Detyrat	D.1.1 – Përgatitja dhe sigurimi i bazës materiale D. 1.2 – Ndërhyrja me prerje para tregtare me intensitet 25% të numrit të drurëve D. 1.3 – Grumbullimi i materialit drusor në togje D. 1.4 – Vlerësimi i materialit drusor	3-13 Shkurt 2025
Rezultatet e pritshme	Krijimi i hapësirave për rritje në kushte më optimale të drurëve të mbetur në n/ngastrën 13b	13 Shkurt 2025

Krahas drejtuesit teknik të punimeve që do ndjekë zbatimin e projektit në baza ditore, do të kryhet edhe monitorimi nga anëtarë të organizatës financuese të projektit dhe ekspertë të jashtëm. Monitorimi do të kryhet gjatë tre fazave, para, gjatë dhe pas kryerjes së punimeve për të vlerësuar nëse punimet janë kryer në përputhje me parashikimet e projektit. Objekt kryesor i monitorimit do të jetë intensiteti i heqjes së numrit të drurëve, cilësia e kryerjes së punimeve, grumbullimi i materialit drusor të rezultuar në togje dhe vlerësimi i materialit drusor. Drejtuesi teknik i punimeve është përgjegjës ndjekjen e të gjitha punimeve dhe zbatimin e kriterëve teknike. Pasi të kryhen punimet do njoftohet struktura përgjegjëse për pyjet në bashkinë Has për marrjen në dorëzim të objektit.

4.2.Shpenzimet për realizimin e projektit

Hequr nga dokumenti origjinal

4.3 Përfitimi ekonomik

Hequr nga dokumenti origjinal

4.5 Analiza e riskut

Aktivitetet	Rreziku identifikuar	Propabiliteti që të ndodhë (U/M/L)	Impakti Riskut (U/M/L)	Masat për zbutjen	Masa shtesë
-------------	----------------------	------------------------------------	------------------------	-------------------	-------------




Rrallime para tregtare	Intensiteti i prerjes së drurëve jo i duhuri	M	L	Ndjekja e punimeve me korrektësi sipas projektit.	
	Cilësia e kryerjes së punimeve (heqja e drurëve jo të duhur, lartësia e prerjes së drurit)	M	L		
	Grumbullimi jo i përshtatshëm i mbeturinave drusore	M	M		
	Kushtet ekstreme të motit (ngricat)	L	L	Njohja paraprake me kushtet e motit	
				Ndalimi punimeve kur moti është i papërshtatshëm	
	Prerjet ilegale	U	L	Komunikimi me banorët e zonës dhe sensibilizimi i tyre	

Shënim: U = i ulët; M = i mesëm; L = i lartë

KAPITULLI V

ANEKSE

5.1 Foto dixhitale të vendit ku do të realizohen punimet:




5.2 Imazhi në Google Earth i objektit dhe koordinatat gjeografike



Pika e poligonit	X (V)	Y (L)	Pika e poligonit	X (V)	Y (L)
1	42°17'38.29"	20°22'37.73"	9	42°17'36.94"	20°22'30.25"
2	42°17'37.59"	20°22'37.45"	10	42°17'37.58"	20°22'29.21"
3	42°17'36.57"	20°22'35.93"	11	42°17'37.92"	20°22'29.22"
4	42°17'35.53"	20°22'33.48"	12	42°17'38.09"	20°22'29.65"
5	42°17'34.95"	20°22'31.56"	13	42°17'38.28"	20°22'29.88"
6	42°17'35.43"	20°22'30.52"	14	42°17'38.07"	20°22'30.37"
7	42°17'36.20"	20°22'30.50"	15	42°17'38.21"	20°22'30.71"
8	42°17'36.52"	20°22'30.56"	16	42°17'38.64"	20°22'31.26"

5.3 Planimetria e parcelës




5.4

Harta e



Ekonomisë Pyjore



Plani i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave Shtator 2021

Legjenda	
• Sipërfaqet Provë	Zonat e Mbrojtura
• Qendrat e Banuara	Kufiri i Ekonomisë Pyjore
• Lartësitë	Kufiri i Parcelës
— Rrugë Kryesore	Kufiri i Nënparcelës
— Rrugë Pyjore	Trupat Ujore
— Rrjedhjet Ujore	

